REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. _____Prot., Tiranë më ____.___.2026

V E N D I M

Nr. 24 datë 29.10.2026

PËR

SHTYRJEN E AFATIT TË VLEFSHMËRISË TË AUTORIZIMIT INDIVIDUAL TË SIPËRMARRËSIT "VODAFONE ALBANIA" SH.A, PËR PËRDORIMIN E FREKUENCAVE TË BREZIT 2100 MHZ (SASI SPEKTRI 2x5 MHZ (FDD))

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	**Gentian Sala**	**Kryetar**
Znj.	**Edlira Dvorani**	**Anëtar**
Z.	**Armer Juka**	**Anëtar**
Z.	**Bleron Dokle**	**Anëtar**
Znj.	**Diana Dervishi**	**Anëtar**

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 29.10.2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" dhe Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)" miratuar me vendimin nr. 11, datë 31.03.2026, të Këshillit Drejtues të AKEP me propozim të Drejtorisë së Administrimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Fundme, shqyrtoi çështjen me objekt shqyrtoi çështjen me objekt:

- Mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual të sipërmarrësit "Vodafone Albania" sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezit 2100 MHz (sasi

spektri 2x5 MHz (FDD))".

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 67 dhe 68 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë";
2. Pika 2, Kreu IV, e VKM-së nr. 496, datë 22.07.2014, "Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim";

KËSHILLI DREJTUES:

Pasi shqyrtoi materialin shkresor, të përbërë nga:

1. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
2. Relacioni shoqërues i projektvendimit;

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar

V Ë R E N:

1. Me Vendimin nr. 4, datë 25.05.2023, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar "Pajisjen me Autorizime Individuale të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit efiçent të këtyre frekuencave", i ndryshuar me Vendimin nr. 11, datë 12.10.2023. Në bazë të këtij vendimi, sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., disponon Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave të brezit 2100 MHz, për sasinë e spektrit objekt të këtij vlerësimi, me afat vlefshmërie deri më 30.10.2026.
2. Me shkresën nr. prot. LEA/053/LR, datë 29.06.2026, sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., ka paraqitur pranë AKEP "Shprehjen e interesit paraprak për pjesëmarrjen në ankandin e brezit 2100 MHz dhe rinovimin e spektrit 2x5 MHz që përfundon në tetor 2026". Në vijim, me shkresën nr. Ref. CEO/033/LR, datë 31.07.2026, protokolluar në AKEP me shkresën nr. 1689 prot., datë 31.07.2026, sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a. ka paraqitur "Aplikim për rinovimin e të drejtave të përdorimit të spektrit në brezin 2100 MHz (sasi spektri 2 x 5 MHz, FDD)", shoqëruar me informacion të zgjeruar mbi përmbushjen e kushteve të përdorimit të brezit të frekuencave 2100 MHz sipas Autorizimit Individual dhe në përputhje me Autorizimin e Përgjithshëm dhe me propozimin mbi çmimin referencë minimal për rinovimin e autorizimit.

3. Në mbështetje të neneve 69 dhe 70 të ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", pikës 8 të nenit 191 të ligjit nr. 54/2024, që përcakton se: *Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, mbeten në fuqi edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kur nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji deri në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji"*, VKM nr. 496, datë 22.07.2014 për "Miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim", Kryetari i AKEP, me Urdhrin nr. 184, datë 16.09.2026, "Për ngritjen e Grupit të Punës për vlerësimin e përmbushjes së të gjitha kushteve të përdorimit të frekuencave të brezit 2100 MHz, për sasi spektri 2 x 5 MHz (FDD), nga sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a.".
4. Në zbatim të Urdhrit nr. 184, datë 16.09.2026, Grupi i Punës, në përputhje me procedurën e përcaktuar në Kreun II të VKM-së nr. 496/2014, mbi bazën e informacionit dhe dokumentacionit të administruar për këtë qëllim, ka kryer vlerësimin e përmbushjes së të gjitha kushteve të përdorimit të frekuencave të brezit 2100 MHz sipas Autorizimit Individual dhe Autorizimit të Përgjithshëm, si dhe të kushteve dhe elementeve të përcaktuara në VKM-në nr. 496/2014 duke nxjerrw nw përfundim të procesit, Raportin Përmbledhës të Vlerësimit mbi përmbushjen e të gjitha kushteve të përdorimit të frekuencave të brezit 2100 MHz (2 x 5 MHz, FDD), nga sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., të shoqëruar me propozimin mbi çmimin referencë minimal për rinovimin e Autorizimit Individual.
5. Grupi i Punës, ka hartuar Raportin Përmbledhës të vlerësimit mbi përmbushjen e të gjitha kushteve të përdorimit të frekuencave të brezit 2100 MHz, nga sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a, shoqëruar me propozimin për çmimin referencë minimal për rinovimin e Autorizimit Individual (protokolluar me shkresën nr. 1689/2 prot, datë 23.09.2026).
6. Në përputhje me nenin 67 dhe 68, të Kodit të Procedurave Administrative dhe bazuar në pikën 2 të Kreut IV të VKM-së nr. 496/2014, të sipërcituar, është parashikuar kompetenca e AKEP për zgjatje të vlefshmërisë së të drejtës së përdorimit të frekuencave nga ana e sipërmarrësit "Vodafone Albania" sh.a., duke pasur parasysh se:

   - mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktonte dëm të pariparueshëm mbi interesin publik dhe të drejtave/interesave të ligjshme të palëve, në përmbushje të plotë të objektivave rregullatore të parashikuara në nenin 12 të ligjit nr. 54/2024;
   - ekzistojnë parakushtet e përcaktuara në ligjin nr. 44/2015 për ushtrimin e autoritetit publik në mënyrë diskrecionare, në marrjen e një vendimi të ndërmjetëm për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual të sipërmarrësit "Vodafone Albania" sh.a., deri në përfundimin e procedurës së negocimit.

7. Neni 67 i ligjit nr. 44/2015 "Vendimet e Ndërmjetme", është i zbatueshëm në të gjitha fazat e një procedure administrative dhe se marrja apo jo e një vendimi të tillë është tërësisht në diskrecion të organit publik kompetent. Për më tepër ,VKM nr. 496 datë 22.07.2014 "Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve

individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim", në Kreun IV të tij, i njeh tagrin AKEP që të ushtrojë të drejtën e marrjes së vendimeve të ndërmjetme në kushtet dhe rrethanat e parashikuara në këtë VKM.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr.54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual të sipërmarrësit "Vodafone Albania" sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezit 2100 MHz (sasi spektri 2x5 MHz (FDD))", miratuar me vendimin e KD nr. 4, datë 25.05.2023, të ndryshuar, deri në marrjen e njoftimit zyrtar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, mbi përfundimin e procedurës së negociimit me sipërmarrësin "Vodafone Albania" sh.a.
2. Të njoftohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a, për këtë vendimmarrje.
3. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë.

Kryetar	**Anëtar**	**Anëtar**	**Anëtar**	**Anëtar**
Gentian Sala	**Edlira Dvorani**	**Armer Juka**	**Bleron Dokle**	**Diana Dervishi**